REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA SHTIME
OPŠTINA ŠTIMLJE/MUNICIPALITY OF SHTIME

Drejtoria për Arsim,
Uprava za Obrazovanje /Department of Education

Nr.prot:05/1004 Datë 13.10.2026

Në mbështetje të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale dhe Rregullores (QRK) Nr. 19/2024 për Procedurat e Përzgjedhjes dhe Emërimit të Personelit Edukativo-Arsimor, përkatësisht nenit 11, paragrafi 2, Drejtoria Komunale e Arsimit në Shtime nxjerr këtë:

VENDIM

PËR ANULIMIN E KONKURSIT PËR ANGAZHIM ME AFAT TË CAKTUAR – ZËVENDËSIM

I. Anulohet konkursi me kod të publikuar **RPC0014056** dhe referencë **RN00020517**, me referencë të rekrutimit nr. **02-111/01-0021141/26**, të datës **02.10.2026**, për pozitën **edukatore me afat të caktuar – zëvendësim**, në SHF "Emin Duraku" në Shtime.

II. Anulimi bëhet për shkak se, gjatë shqyrtimit të mundësive për plotësimin e pozitës për zëvendësim, është konstatuar se duhet të zbatohen mekanizmat e përzgjedhjes nga listat përkatëse të kandidatëve, në përputhje me nenin 11, paragrafi 2, të Rregullores (QRK) Nr. 19/2024, duke marrë parasysh procedurën e konkursit të rregullt për pozitën e edukatores në Institucionin Parashkollor "Albiona Asllani" në Shtime.

III. Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore, në bashkëpunim me Drejtorinë Komunale të Arsimit, obligohet të ndërmarrë veprimet e nevojshme për plotësimin e pozitës së edukatores për zëvendësim, duke respektuar rendin e përzgjedhjes, kriteret dhe procedurën e përcaktuar me Rregulloren (QRK) Nr. 19/2024.

IV. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Drejtoria Komunale e Arsimit në Shtime, më 02.10.2026, ka publikuar konkursin me kod RPC0014056 dhe referencë RN00020517, me referencë të rekrutimit nr. 02-111/01-0021141/26, për pozitën edukatore me afat të caktuar – zëvendësim në SHF "Emin Duraku" në Shtime.

Ndërkohë, është duke u zhvilluar procedura e konkursit të rregullt për pozitën e edukatores në Institucionin Parashkollor "Albiona Asllani" në Shtime. Gjatë shqyrtimit të mundësive për plotësimin e pozitës për zëvendësim, është vlerësuar nevoja për zbatimin e mekanizmave të përzgjedhjes nga listat e kandidatëve të përcaktuara me Rregulloren (QRK) Nr. 19/2024.

Neni 11, paragrafi 2, i kësaj Rregulloreje përcakton rendin e përzgjedhjes së kandidatëve për angazhim me afat të caktuar, duke përfshirë listën e kandidatëve fitues të formuar pas përfundimit të konkursit të rregullt. Për këtë arsye, plotësimi i pozitës për zëvendësim duhet të trajtohet në përputhje me rendin dhe kushtet ligjore të përcaktuara për përzgjedhjen e kandidatëve.

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA SHTIME
OPŠTINA ŠTIMLJE/MUNICIPALITY OF SHTIME

Drejtoria për Arsim,
Uprava za Obrazovanje /Department of Education

Duke u bazuar në sa më sipër, Drejtoria Komunale e Arsimit vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi, pala e pakënaqur mund të paraqesë ankesë brenda afatit 15 ditor , pranë Komisioni Komunal për Shqyrtimin e Ankesave për Sektorit e Arsimit nëpërmjet Drejtorisë Komunale të Arsimit në Shtime. Paraqitja e ankesës nuk e pezullon ekzekutimin e këtij vendimi.

Një kopje i dorëzohet:

Njësisë për Burime Njerëzore

Udhehqeës i sektorit të arsimit

Lulzim Sahiti

Adresa: Rr. Tiranës, 72000, Shtime, Republika e Kosovës.
Tel.: +381290389016, email: info@shtime-komuna.org
http://kk.rks-gov.net/shtime